



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilbena/Pridata Received/Delivery	01.12.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRINSHKILL	7198	/2023	1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1297/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1297/2023 të datës 17.10.2023 të parashtruar nga [redacted] nga Drenasi kundër Vendimit KA.Nr.34/2023 të datës 03.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1297/2023 e datës 17.10.2023 e parashtruar nga [redacted]

II.Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.34/2023 i datës 03.10.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

[redacted] (tutje referuar si ankuesja), kandidate në procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar Ligjor 2", në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, me datë 17.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6567/2023 të regjistruar nën shenjë A.nr. 1297/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër KA.Nr.34/2023 të datës 03.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshilli Prokurorial i Kosovës, ndërsa me datë 23.10.2023, nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje referuar *Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën A.nr.1297/2023 të datës 17.10.2023; drejtuar Këshillit; Vendimi KA. Nr. 34/2023, i datës 03.10.2023, i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankese e datës 20.09.2023, drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftime i datës 06.09.2023, për përzgjedhjen përfundimtarë; Rezultatet për Testim me shkrim; Njoftimi i datës 18.08.2023, për përzgjedhjen në listën e ngushtë; Konkursi i datës 28.08.2023; Vendimi me numër protokolli 1260/2023, i datës 17.08.2023, për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Regjistrimi i Aplikacionit të Pranuar; Testi me shkrim i ankueses; Testi me shkrim i kandidatit të përzgjedhur; Rekomandimi Final nga Komisioni Rekrutues; Aplikacioni për punësim i Kosovare Thaqi - Gashi, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 3167, e datës 24.03.2015; Vërtetim i datës 05.01.2017; Vërtetim i datës 30.06.2023; Reference e datës 30.06.2023; Reference e datës 04.01.2017; Letër reference e datës 30.09.2021; Diplomë e datës 15.07.2015; Certifikatë e datës 02.08.2023; Aplikacioni për punësim i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 7453, e datës 28.03.2021; Certifikatë e datës 23.03.2023; Formuari për vlerësim e praktikantit; Reference e datës 30.09.2021; Diplomë e datës 16.05.2012; Vërtetim i datës 30.07.2023; Testi me shkrim çelësi; Përmbledhja e vlerësimeve Individuale; Përmbledhje e vlerësimeve Individuale e testimit me shkrim; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 1297/2023, e datës 23.10.2023;

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara nga palët ne procedurë, konstatoi se ankesa A.nr.1297/2023 e datës 17.10.2023 e parashtruar nga , është e pa bazuar sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje referuar SKPK), me datë 28.07.2023, ka shpallur Konkursin me numër reference KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/POZ-012 për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor-2", në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja dhe e njëjta sipas shkresave të lëndës ka marr pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit (duke përfshirë listën e ngushtë, testin me shkrim dhe intervistës me gojë). Rrjedhimisht, në përfundim të procedurës së rekrutimit, me datën 06.09.2023, është publikuar njoftimi lidhur me kandidatin e suksesshme, nga i cili rrjedh se ankuesja nuk është përzgjedhur për emërim në pozitën përkatëse të punës.

Ankuesja e pakënaqur me Njoftimin e datës 06.09.2023, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshme, me datë 20.09.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, ndërsa ky i fundit me Vendimin me numër KA. Nr. 34/2023 të datës 03.10.2023 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses dhe ka lënë në fuqi Njoftimin e datës

06.09.2023 për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshme pozitën "Zyrtar Ligjor 2", në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Kundër Vendimit me numër KA.Nr.34/2023 të datës 03.10.2023 të SKPK, ankuesja me datë 17.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se ky vendim është nxjerr përmes shkeljes së dispozitave të ligjit material dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike ngase i njëjti komision nuk ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore dhe si rrjedhojë nuk marr parasysh faktin se e njëjta në testin me shkrim ka marr me shumë pikë (83 pikë) se sa kandidati fitues i cili në testin me shkrim ka marr vetëm 68 pikë; Komisioni përzgjedhës ka shkelur procedurën e vlerësimit sepse një pyetje e parashtruara ka qenë për Bankën Qendrore dhe kompetencat e saj e që nuk ka pasur asgjë të bëjë me pozitën që ka aplikuar; Nuk janë publikuar rezultatet përfundimtar për të gjithë kandidatët.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se e njëjta në testin me shkrim është vlerësuar me më shumë se kandidati fitues, Kolegji i Këshillit nga administrimi dhe vlerësimi i provave të lëndës ka konstatuar se ankuesja në testin me shkrim ka mbledhur 83 pikë, ndërsa kandidati fitues 68 pikë, mirëpo sipas dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil (e aplikueshme në rrethanat e rastit konkret), gjegjësisht nenit 32 paragrafi 2 testimi i kandidatëve bëhet në dy faza, dhe atë përmes testimit me shkrim dhe testimit me gojë, dhe se ankuesja në testimin me gojë ka mbledhur 53 pikë, ndërsa kandidati fitues ka mbledhur 72.2 pikë, nga rrjedh se pas mbledhjes dhe pjesëtimit për dy (piket e testi me shkrim dhe intervistës me gojë) ankuesja ka mbledhur gjithsejtë 68% të pikeve, ndërsa kandidati fitues M. Bunjaku ka mbledhur gjithsejtë 70.1 % të pikeve, andaj në këtë kuptim pretendimi ankimor i ankueses është i pa bazuar sepse sipas dispozitave të nenit 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në Shërbimin Civil emërohen kandidatet të cilët kanë arritur numrin me të madh total të pikeve të mbledhura në testin me shkrim dhe me gojë.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankesës se komisioni ka shkelur procedurën e vlerësimit ngase njëra nga pyetjet e parashtruara ka qenë për Bankën Qendrore dhe kompetencat e saj dhe si e tillë nuk ka pasur asgjë të bëjë me pozitën e shpallur, Kolegji i Këshillit ju referuar nenit 36 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se testi me shkrim ndahet në këto pjesë: *Pjesa e njohurive të Përgjithshme* përmban tri (3) pyetje në formë eseje, *Pjesa e aftësiave të përgjithshme dhe të personalitetit* përmban dymbëdhjetë (12) pyetje me përgjigje të shumëfishta, ndërsa *Pjesa e njohurive lidhur me vendin e punës* përmban gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje prej tyre tetë (8) me përgjigje të shumëfishta dhe tetë (8) në formë eseje dhe si rrjedhojë në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit testi me shkrim ka qenë i përpiluar në pajtim me procedurën e përcaktuar me aktin përkatës nënligjor, ndërsa me nenin 38 të rregullores përkatëse është përcaktuar se testimi me gojë përbëhet prej këtyre pjesëve: *Pjesa për testimin e personalitetit dhe të planeve profesionale; Pjesa për testimin e njohurive të përgjithshëm institucionale dhe ekonomike dhe Pjesa për testimin e njohurive që lidhen me vendin e punës*, nga rrjedh se pyetja për Bankën Qendrore dhe kompetencat e saj hynë në kuadër të pyetjeve që ndërlidhen me *Pjesën për testimin e njohurive të përgjithshëm institucionale dhe ekonomike*, kështu që në këtë aspekt pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se nuk janë publikuar rezultatet përfundimtare të kandidatëve, ju referua nenit 41 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *"Institucioni përkatës është përgjegjës për shpalljen e rezultateve të procedurës së rekrutimit në faqen e internetit të institucionit. Njoftimi përmban emrat e kandidatëve të suksesshëm, vendin e punësimit dhe pikët e fituara gjatë procedurës së përzgjedhjes"*, si rrjedhojë duke ju referuar kësaj dispozite ligjore Kolegji i Këshillit konstaton se SKPK me rastin e publikimit të Njoftimit të datës 06.09.2023 për kandidatin e suksesshëm i cili përmban emirin dhe piket e kandidatit të suksesshëm/përzgjedhur ka përmbushur detyrimet ligjore si me lartë, derisa njoftimi i kandidatëve tjerë behet përmes komunikimit në mënyrë individuale, kështu që edhe ky pretendim ankimor si i tillë është i pabazuar.

Kolegji i Këshillit, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore po ashtu analizoi edhe kriteret e konkursit për pozitën përkatëse të cilat ishin: *Diplome Universitare; Fakulteti Juridik; Një (1) vite përvojë pune profesionale*, dhe se në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës konstatoi se kandidati i suksesshëm, M. Bunjaku lidhur me përgatitjen profesionale ka dorëzuar Diplomën me Nr.7453 të datës 28.04.2021 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën vërtetohet se i njëjti ka të kryer Fakultetin Juridik më datë 28.01.2021, duke marr kështu titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, ndërsa lidhur me kriterin e përvojës se punës ka dorëzuar Certifikatën SKPK/DBNJ/Nr.03 të datës 23.03.2023 të lëshuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës për kryerjen e stazhit të praktikës nga data 01.12.2021 deri më datë 30.11.2022. Po ashtu, ankuesja lidhur me kriterin e kualifikimit ka dorëzuar Diplomën me Nr.3167 të datës 24.04.2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën vërtetohet se ka të kryer Fakultetin Juridik më datë 11.11.2014 duke marr titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, ndërsa lidhur me kriterin e përvojës së punës e njëjta posedon Certifikatën GJA.nr.9/017 të datës 05.01.2017 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për kryerjen e stazhit të praktikës nga data 05.01.2016 deri më datë 05.01.2017, Vërtetimin e datës 30.06.2023 nga Oda e Avokatëve të Kosovës për kryerjen e praktikës prej datës 01.07.2022 deri më datë 30.06.2023. Bazuar si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes se ankueses dhe kandidatit të përzgjedhur në listën e ngushtë ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *"1. Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë:1.1. arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2 përvojën e punës"*, ngase kandidatet kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në konkurs. Rrjedhimisht, nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe mbi bazën e konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi është konstatuar po ashtu se Komisioni Përzgjedhës gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën *"Zyrtar Ligjor-2"* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ka vepruar në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 18 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"*, ngase nuk është vërtetuar asnjë shkelje procedurale dhe materiale sikurse pretendonte ankuesja dhe si e tillë

ankesa është e pabazuar. Si rrjedhojë, edhe Vendimi numër KA.Nr.34/2023 i datës 03.10.2023 i SKPK, përmes të cilit është refuzuar ankesa e ankueses, është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, pasi që është vërtetuar drejtë gjenden faktike dhe drejtë është zbatuar baza juridike dhe se pretendimet ankimore janë shqyrtuar në pajtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1297/2023

Rushit Kajtazi

Prozeshmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, Kosovare;
- Udhëheqëses se Personelit në Këshillin Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.